



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ___/ ___/ 2019

Lënda: Kthim përgjigje.

Z. _____

_____, **Shkodër.**

Në përgjigje të kërkesës tuaj nr praktike 8969 datë 08.07.2019 për “Kërkesë për informacion”, ju informojmë sa më poshtë:

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr 598 datë 14.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Bashkia Shkodër, të qarkut Shkodër”, janë transferuar pranë Bashkisë Shkodër (qytet) pronat pyje/kullota, pjesë e të cilave është edhe EPK Bahçallëk, me emërtesë popullore Kampi Bahçallëk , me sipërfaqe totale 35733.5 m2.

Bazuar në këtë vendim Bashkia Shkodër ka kryer procedurat për regjistrimin e pronave pyje/kullota pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Palujtëshme Shkodër.

Aktualisht bazuar në Ligjin nr 9385/2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar ,neni 1pika 3, VKM nr 433/2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, kjo pronë administrohet nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

ZV/K R Y E T A R

Arben GJURAJ